



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi,

Në mbështetje të nenit 65 (14) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të rregullave 31.3 dhe 46 të Rregullores së Punës, në seancën plenare të mbajtur më 12 dhjetor 2008, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për fillimin e procedurave për privatizimin e distribuimit të furnizimit në KEK, miratoi këtë

V E N D I M

Kuvendi mbështetet në parim, nismën e procesit të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut, duke përcaktuar prioritetet në kuadër të procesit të privatizimit, si vijon:

1. Së pari duhet të realizohet-përfundohet transformimi i plotë organizativ i korporatizimit të KEK-ut, duke i përcaktuar statusin formalo-juridik të secilës njësi në kuadër të Ndërmarrjes publike të KEK-ut.
2. Gjatë vitit 2009 të përcillen dhe të merren parasysh rezultatet e afarizmit ekonomik për secilën njësi veç e veç;
3. Të merret parasysh ndikimi i krizës globale në çmimin ofertues në procesin e privatizimit, dhe;
4. Procedurat e privatizimit të fillojnë, varësisht nga rezultati i fizibilitetit (konkluzioneve analitike në aspektin afarizmit ekonomik), me kusht që privatizimi i njësisë së caktuar, të jetë prioritet dhe përparësi ekonomike për vendin.

Nr. 03-V-074

Prishtinë, më 12 dhjetor 2008

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Rekomandimi t'u dërgohet:

- Qeverisë së Kosovës,
- Komisionit për Ekonomi, Tregti, Energjetikë,
- Arkivit të Kuvendit.